



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Kuvendi - Propozime dhe Parashitresa - Kancelaria za Predlogi i Predstavke - Table Office

Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No: 06/1342/Do-746
Date Datum Date: 21.05.2018
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	z. Shyqiri Bytyqi- Ministër i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	DATE DATU M DATE	21.05.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Arbërie Nagavci, deputete e Lëvizjes VETËVENDOSJE! <i>A Nagavci</i>		
SUBJE KTI PREDM ET SUBJE CT	Pyetje Parlamentare (për përgjigje me shkrim)		

Në bazë të Rregullës 46 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje parlamentare për përgjigjeje me shkrim.

ÇËSHITJA: Rreziku i shkëputjes së lidhjes zyrtare të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve

Ashtu sikurse besoj se jeni në njohuri, më 8 Dhjetor 2016, në Bruksel është bërë referencimi apo lidhja zyrtare e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK) , një vit pas anëtarësimi të Kosovës në grupin këshilldhënës të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve .

Referencimi apo lidhja zyrtare e KKK me KEK është arritur si rezultat i një procesi 4 vjeçar të përpilimit të raportit të referencimit, në përputhje me metodologjinë dhe kriteret rigorozë të KEK-se dhe është rezultat i një procesi të gjatë konsultativ me të gjitha palët e interesit si MASHT,

Agjencia e Akreditimit të Kosovës përfshirë edhe ekspertët ndërkombëtar, me ç'rast pasqyron në mënyrë transparente dhe reale sistemin tonë të arsimit dhe trajnimit në të gjitha nivelet duke përfshirë të arriturat, sfidat dhe veprimet e planfikuar për t'i tejkaluar këto sfida duke mundësuar në këtë mënyrë krahasimin në mes KKK-së me KEK.

Referencimi do të thotë që sistemi jonë i arsimit dhe trajnimit është transparent, i qartë dhe i besueshëm për shtetet anëtare të BE-së dhe kualifikimet apo diplomat dhe certifikatat e programevet të studimeve dhe trajnimeve janë të krahasueshme përmes KEK me kualifikimet e vendeve të BE-se duke lehtësuar kështu njohjen dhe qasjen e të rinjëve tanë me diploma dhe kualifikime të Republikës së Kosovës në tregun Evropian të punës. Pra, i shërbejnë shtetasëve tanë që me diploma dhe kualifikime të Republikës së Kosovës të punësohen në tregjet e shteteve të BE-së.

Kjo krahasueshmëri apo njohje vlen vetëm për diplomat apo certifikatat e programeve studimi/trajnimi që janë pjesë e KKK-së- certifikatave dhe diplomave të programeve që janë të akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe Agjencia e Akreditimit të Arsimit të Lartë.

Me rastin e referencimit, nga anëtarët e Grupit Këshilldhënës të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve nga Kosova është kërkuar që të raportojë për progresin e arritur në implementimin e Kornizës pas lidhjes apo referencimit me KEK.

Duke marr parasysh që implementimi i KKK-së është përgjegjësi e ndarë në mes të MASHT, AKK dhe AAK, përkundër faktit që AKK sipas legjislacionit në fuqi koordinon dhe udhëheq këtë proces, progresi i zbatimit të KKK-së varet nga puna e përbashkët e këtyre 3 institucioneve, megjithatë MASHT, ndonëse do të duhej të printe në këtë proces, duket se ka ngec prapa në realizmin e disa aktiviteteve të ndërlidhura me këtë mekanizëm.

Përgjegjësi e MASHT-it është të fillojë zbatimin e vendimit të Ministrit të MASHT të vitit 2016 lidhur me përfshijnë e shkollave publike në KKK përmes procesit të akreditimit.

Marr parasysh që procesi i akreditimit është proces publik, deri tani nuk ka te dhëna që ndonjë nga shkollat publike i është nënshtrua këtij procesi. Mendoj se MASHT akoma nuk ka ndërmarrë ndonjë hap në zbatimin e këtij vendimi.

Ju lutem të na njoftoni se a ka filluar MASHT me procesin e akreditimit në mënyrë që të përfshijnë një numër të shkollave që plotësojnë kushtet për akreditim në KKK dhe të këtë mundësi të raportohet për progres në këtë drejtim?

Në një adresim tuajin në lidhje me këtë çështje në Kuvend, ju keni deklaruar se nga ardhja juaj në krye të MASHT, keni incizuar gjendjen , sidomos në arsimin profesional, se keni kontaktuar Këshillin drejtues të AKK, keni biseduar për sfidat dhe jeni dakorduar për një takim me shkollat profesionale/ tryezë ku kemi marrë propozime. Poashtu keni deklaruar se deri në fund të vitit 2018, prisni anëtarësim dhe validitim të programeve

z. Ministër

A ka ndonjë veprim konkret nga ana e MASHT në drejtim të akreditimit, gjegjësisht inkurajimit dhe mbështetjes së shkollave, apo njoftimit të tyre për të aplikuar për akreditim?

Mendoj se është e mjaftueshme në këtë stad të fillohet së paku me 5-6 shkolla publike dhe këtu mund të përfshihen qendrat e kompetencës në Ferizaj dhe Prizren të cilat janë të përgatitura nga LUX që t'u nënshtrohen procesit të akreditimit dhe nevojitet vetem të dorëzojnë aplikacionin në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve.

Kosova patjetër duhet ta bëjë një progres në këtë drejtim dhe ne duhet të raportojmë për të deri në fund të këtij viti.

Por, gjithësesi se ne s' duhet ta shohim akreditimin vetëm për të raportuar në Bruksel. Për të gjithë ne, e sidomos për MASHT, është e nevojshme të kemi një skenim të gjendjes dhe pasqyrë të qartë për gjendjen e shkollave profesionale, t'i përmirësojmë ato dhe të dimë se ku mund t'i orientojmë donatorët, pasi ka mjaft projekte që mbështesin shkollat profesionale dhe lidhjen e tyre me tregun e punës.

Për më tepër, duhet theksuar se gjendja në rajon dallon prej nesh, është shumë me rëndësi ta zëmë procesin sepse kemi mundësi. Duhet të kemi parasyshë se:

- Ne kemi pasur shumë më shumë probleme me njohje të sistemit tonë për arsye politike që dihen;
- kemi nevojë për besueshmëri të sistemit tonë arsimorë me shumë se të tjerët;
- ndihmon lidhjen konkrete të shkollave ne Tregun e Punës;
- pastaj ne jemi të referencuar dhe nuk duhet ta humbim këtë lidhje;
- papunësia tek ne është më e larta, pastaj mosha e popullatës është më e reja;
- Njohja e mësimit paraprak dhe certifikimi (RPL) është shumë e rëndësishme sepse kemi pasur shumë të zhvendosur që kanë jetuar dhe punuar në përfundim dhe kanë marrë zanate, por nuk i kanë të certifikuar ato ,etj.

I nderuar, z. Ministër,

Nëse brenda 6 muajve nuk arrijmë t'i fusim disa shkolla në këtë proces, rreziku që të humbet referencimi është shumë i madh.

Nëse shkëputet KKK nga KEK do të rrezikohet punësimi i qytetarëve tanë me certifikata të akredituara nga AKK në tregun Evropian të punës dhe do të mbetet në diskrecionin e shteteve anëtare të BE-së veç e veç të vendosin a besojnë në cilësinë e certifikatave tona. Prandaj, puna e institucioneve tona në përmbushjen e obligimeve që dalin nga procesi i referencimit është thelbësorë për të dëshmuar progresin e bërë dhe është koha e fundit të fillohet me realizmin e aktiviteteve në këtë drejtim.

Fare në fund dua të risjell në vëmendjen tuaj që është përgjegjësi e MASHT që të inicojë zbatimin dhe monitorimin e Vendimeve të veta, andaj dhe Vendimit të Ministrit të vitit 2016 lidhur me përfshijnë e shkollave publike në KKK përmes procesit të akreditimit.

Me shpresën se në përgjegjën tuaj do të na njoftoni për veprimet konkrete në drejtim të fillimit të procesit të akreditimit për së paku disa shkolla.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI / SKUPŠTINA / ASSEMBLY
ASSEMBLY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO
Kuvendi i Kosovës / Skupština / Kuvendi i Kosovës

06/1378/10-772

24.05.2018

KORAB R. SEJDIU

Deputet
Poslanik – Representative

Për / Za / For:	Z. Dardan Gashi, Ministër Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike
Nga / Od / From:	Korab R. Sejdiu, Deputet
Data / Datum / Date:	24 maj 2018
Referenca / Referenca / Reference:	05/2018
Lënda / Predment / Subject:	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim.

Çështja: Javën që shkoi, patëm rastin dhe kënaqësinë që të takohemi me një numër të madh të përfaqësuesëve të diasporës shqiptare nga pothuajse të gjitha kontinentet. Gjatë takimeve, përfaqësuesit e diasporës paraqitën një numër të caktuar çështjesh që duhet adresuar nga Republika e Kosovës për t'iu siguruar tretman dinjitoz kësaj pjese shumë të rëndësishme të shoqërisë sonë. Ndër të tjera, ata paraqitën çështjet si në vijim:

- Përmirësimi dhe lehtësimi i procedurave për votim në zgjedhjet qendrore dhe lokale në Kosovë;
- Përfaqësimi i diasporës në Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- Mbështetjen e mësimit plotësues;
- Themelimi dhe mbështetja e Këshillit Kombëtar të Diasporës;
- Themelimi dhe mbështetja e Fondacionit Global Filantrop të Diasporës;
- Adresimin e çështjes së kartonit të gjelbër dhe pagesave që bëhen nga diaspora gjatë hyrjes në territorin e Republikës së Kosovës me mjete motorrike;
- Përfshirjen e profesionistëve nga diaspora në adresimin e problemeve me të cilat ballafaqohet Kosova dhe në politikbërje; dhe
- Adresimin e pagesave të larta gjatë tërheqjes së të hollave në bankomate në Kosovë (nga llogaritë në vendin e origjinës).

PYETJA: Z. Ministër, pasur parasysh rëndësinë e veçantë që diaspora ka për vendin tonë, ju lus që të na informoni nëse jeni i vetëdijshëm për nevojat e paracakura që ka diaspora jonë. Nëse po, atëherë, çfarë plane urgjente keni ju dhe kolegët tuaj për të adresuar të njëjtat?

Email: Korab.Sejdiu@assembly-kosova.org
Tel: +377 (0)44 470 045
Skype: korab.r.sejdiu

Ndërtesa e Kuvendit
Sheshi Nëna Tereze
Kutia/Box 70
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

KORAB R. SEJDIU

Deputet

Poslanik – Representative



Për / Za / For:	Z. Bedri Hamza, Ministër Ministria e Financave
Nga / Od / From:	Korab R. Sejdiu, Deputet 
Data / Datum / Date:	24 maj 2018
Referenca / Referenca / Reference:	04/2018
Lënda / Predment / Subject:	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim.

Çështja: Në fillim të vitit 2017, është miratuar/shpallur dhe ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 05/L-090 për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Si edhe mund ta imagjinoni, ky ligj është jetik për zhvillimin dhe mbështetjen e rinisë, kulturës dhe sportit në Republikën e Kosovës. Mirëpo, kohëve të fundit, kemi marrë ankesa të bazuara të cilat na njoftojnë se Administrata Tatimore e Republikës së Kosovës ("ATK") është duke refuzuar zbatimin e këtij ligji, duke dëmtuar në veçanti sportistët të cilëve po iu mohohet mbështetja nga sponsorët.

PYETJA: Z. Ministër, pasur parasysh këtë rëndësi të madhe të këtij ligji për rininë dhe komunitetet e kulturës dhe sportit, a jeni në dijeni për këtë qëndrim të kundërligjshëm të ATK-së. Poashtu, cilët janë hapat urgjent që do të ndërmerri për të ndërprerë këtë praktikë të jashtëligjshme nga ATK.

Email: Korab.Sejdiu@assembly-kosova.org
Tel: +377 (0)44 470 045
Skype: korab.r.sejdiu

Ndërtesa e Kuvendit
Sheshi Nëna Tereze
Kutia/Box 70
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës